

RELACION

PËR

PROJEKTVENDIMIN

“PËR

PËRCAKTIMIN E RASTEVE PËR DHËNIEN NË PËRDORIM DHE PËR NDRYSHIMIN E KATEGORISË SË PËRDORIMIT, PROCEDURAT DHE DOKUMENTACIONI PËRKATËS PËR NDRYSHIMET E SIPËRFAQEVE DHE PAKËSIMIN NË VOLUM NGA FONDI PYJOR KOMBËTAR APO ZGJERIMIN E TYRE”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Qëllimi i këtij projektvendimi është që të përcaktojë rastet e dhënies në përdorim dhe të ndryshimit të kategorisë së përdorimit, si dhe të përcaktojë rregullat dhe dokumentacionin e nevojshëm për procedurat e ndryshimit të kategorisë së përdorimit (heqjen/shtimin) të fondit pyjor kombëtar apo të pakësimit në volum të tij.

Fondi pyjor kombëtar është objekt i zhillimit të aktiviteteve të përdorimit, për arsye ekonomike dhe të tjera, të cilat nga njëra anë synojnë ruajtjen, shtimin dhe mos-cënimin e funksioneve të pyllit dhe, nga ana tjetër këto aktivitete ndikojnë në sigurimin e të ardhurave, rritjes së mirëqenies dhe të punësimit.

Fondi pyjor kombëtar, është gjithashtu objekt i zhvillimit mbi të, të një sërë aktiviteteve ma natyrë kryesisht ekonomike, të cilat gjatë zhvillimit të tyre ndryshojnë formën e përdorimit dhe për këtë arsye ato i nënshtrohen procedurës së heqjes ose ndryshimit të kategorisë së përdorimit, për t'u vënë në dispozicion të veprimtarisë së kërkuar.

Objektivat që synohen të arrihen nëpërmjet këtij projekt vendimi janë pikërisht:

- përcaktimi i rasteve të dhënies në përdorim të fondit pyjor kombëtar dhe rasteve të ndryshimit të kategorisë së përdorimit dhe pakësimit në volum të tij;

- përcaktimi i procedurës dhe rregullave që ndiqen, si dhe dokumentacionin e nevojshëm për ndryshimin e kategorisë së përdorimit dhe pakësimin në volum të fondit pyjor kombëtar.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Miratimi i këtij dokumenti është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve të Këshillit të Ministrave për vitin 2022, miratuar me VKM-në nr. 850, datë 29.12.2021, “Për miratimin Programit të Përgjithshëm Analitik të projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2022”.

Njëkohësisht citojmë se draftimi i këtij projektvendimi u hartua nga grupi i punës i ngritur me Urdhërin e Ministrit të MTM, nr. 59, datë 08.02.2022, “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projektakteve të planifikuara për 4-mujorin e dytë, në zbatim të Programit të Përgjithshëm Analitik të Projektakteve për vitin 2022”

Projektvendimi është parashikuar gjithashtu në ligjin 57/2020, datë 30.04.2020, “Për pyjet”, që lidhet e buron nga Dokumenti i Politikave për Pyjet 2019-2030, miratuar me VKM nr. 814, datë 31.12.2018. Në këtë dokument, janë planifikuar aktivitete dhe hapa të rëndësishëm për të garantuar zhvillimin e qëndrueshëm të fondit pyjor, për të maksimizuar përfitimet dhe për të vendosur e ruajtur ekuilibrat natyrorë mbi të.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Aktivitetet e planifikuara për t’u zhvilluar mbi fondin pyjor, duhet të programohen e standartizohen, më qëllim garantimin e vijueshmërisë, ruajtjen e ekuilibrave natyrorë, mbrojtjen e biodiversitetit dhe shtimin e vlerave ekologjike, në përputhje të plotë me objektivat e planeve të mbarështimit e zhvillimit të tyre.

Projekt vendimi, është një akt që synon të rregullojë dhe të konturojë procedurat mbi të cilat do të kryhen këto veprimtari mbi fondin pyjor.

Projekt vendimi qartëson rastet kur jepet në përdorim fondi pyjor kombëtar dhe rastet e heqjes, dhe/ose ndryshimit të kategorisë së përdorimit duke i hapur rrugën hartimit të një Udhëzuesi të ri, për rregullat, kërkesat, procedurat dhe dokumentacionin i nevojshëm për marrjen në përdorim të fondit pyjor kombëtar.

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për përcaktimin e rasteve për dhënien në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre”

Udhëzuesi në kontekstin e tij, do të orientojë strukturat përgjegjëse të pyjeve pranë Njësive të Vetëqeverisjes Vendore se si të finalizojnë procedurën e dhënies në përdorim të sipërfaqeve pyjore. Ndërsa për pjesën e ndryshimit të kategorisë së përdorimit (heqjes/shtimit) të fondit pyjor kombëtar, projektvendimi qartëson plotësisht, si rastet kur kërkohen për ndryshimin e kategorisë së përdorimit (heqje/shtim), edhe rastet specifike kur aktivitetet me interes kombëtar realizohen në zonat e mbrojtura, ashtu edhe procedurat që duhet të ndiqen.

Procedura e dhënies në përdorim ndiqet nga strukturat përgjegjëse të pyjeve pranë Njësive të Qeverisjes Vendore, dhe akti për këtë qëllim legjitimohet nëpërmjet Kryetarit të Bashkisë.

Përdorimi i fondit pyjor mbi baza të përcaktuara dhe të rregulluara ligjërisht, garanton jo vetëm mbrojtjen e zhvillimin e tij, por njëkohësisht është burim i mirëfilltë për sigurimin e të ardhurave, rritjen e mirëqenies, hapjen e vendeve të reja të punës dhe ka efekte të forta në zbutjen e varfërisë të zonave rurale.

Njëkohësisht, përcaktimi i rasteve dhe procedurave për ndryshimin e kategorisë së përdorimit të fondit pyjor (heqjes/shtimit), për aktivitete që gjatë zbatimit/zhvillimit, çojnë në prishjen dhe dëmtimin e resurseve natyrore/pyjore, do të garantojë ruajtjen e ekuilibrave natyrorë, gjendjen dhe vijimësinë e pyjeve në përgjithësi.

Përparësi tjetër e këtij projektvendimi, është se shërbimi për të gjithë aplikuesit do të ofrohet on-line nëpërmjet platformës e-albania. Mbështetur kjo në Urdhërin e Kryeministrit Nr. 153, datë 25.11.2019, “Për marrjen e masave dhe rregullimin e dispozitave ligjore për aplikimin e shërbimeve vetëm on-line, nga data 1.1.2020”, si dhe në Urdhërin e Ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, nr. 392, datë 11.12.2019, “Për marrjen e masave dhe rregullimin e dispozitave ligjore për aplikimin e shërbimeve vetëm on-line, nga data 1.1.2020”

Problematikat lidhen vetëm me bashkëpunimin ndër-institucional dhe kryesisht marrëdhëniet e letërkëmbimit të institucionit qëndror me Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, të cilat shpesh shkaktojnë vonesa për shkak të radhës së planifikuar të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak.

Ofrimi i shërbimit on-line nëpërmjet portalit *e-albania*, do të ketë efekte pozitive që lidhen kryesisht me shpejtësinë e përpunimit dhe procesimit të kërkesës për ndryshimin e kategorisë së përdorimit.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi si akt nënligjor nxirret në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 57/2020, datë 30.04.2020, “Për pyjet”. Ligji, në pikën 4 të nenit 5, citon shprehimisht: “Për

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për përcaktimin e rasteve për dhënien në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre”

rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre miratohen nga Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrit ”

Projektvendimi është në harmoni të plotë me kushtetutën dhe nxirret mbështetur në nenin 100 të saj. Është gjithashtu në harmoni dhe nuk bie ndesh me legjislacionin në fuqi vendas dhe atë ndërkombëtar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS* TË BE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektvendimi është dokument teknik i dalë në zbatim të ligjit nr.57/2020, datë 30.04.2020, dhe nuk synon përafrim të legjislacionit.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË DOKUMENTIT

Projektvendimi është i strukturuar në shtatë krerë:

Në kreun I, të projektvendimit, “Dispozita të përgjithshme”, jepen objektivat dhe qëllimi i projektvendimit, si dhe shpjegimi i terminologjisë së pëdorur në projektvendim.

Në kreun II, “Rastet e dhënies në përdorim” dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit”, të strukturuar në 3 pika, jepen të gjitha rastet kur sipërfaqet pyjore jepen në përdorim, dhe rastet kur ato i nënshtrohen ndryshimit të kategorisë së përdorimit. Në kreun III, jepen rastet e ndryshimit të kategorisë së përdorimit, e strukturuar në 3 pika dhe në 9 nënpika të pikës 1.

Në kreun IV, “Procedura dhe dokumentacioni për dhënien në përdorim të fondit pyjor”, projektvendimi citon të drejtën e bashkive për të kryer procedurat e dhënies në përdorim, dhe hartimit të një udhëzimi të Ministrit që rregullon këto procedura.

Kreu V, “Procedura që ndiqet për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre”, i strukturuar në 13 pika, trajton të gjitha procedurat që duhet të ndiqen për ndryshimin e kategorisë së përdorimit. Në pikën 1 të këtij kreu, theksohet se shërbimi do të ofrohet nëpërmjet portalit *e-albania*, gjë që konsiderohet edhe si risi e këtij projektvendimi. Në pikat e tjera projektvendimi orienton kërkuesin mbi procedurat e aplikimit në portalin *e-albania*. Në pikat në vijim, projektvendimi saktëson instancat përkatëse që procesojnë, afatet kohore dhe llojin e aktit të miratimit/refuzimit, për kërkuesin.

Në kreun VI, projektvendimi trajton dhe sqaron kërkuesin mbi të gjithë dokumentacionin që kërkohet për të aplikuar për ndryshimin e kategorisë së përdorimit. Ky kre është i strukturuar në 2 pika dhe 7 nënpika.

Në kreun VII, projektvendimi citon dispozitat kalimtare dhe aktet e tjera në fuqi që shfuqizohen me hyrjen në fuqi të këtij projektvendimi.

Relacion shpjegues për projektvendimin “Për përcaktimin e rasteve për dhënien në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit, procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre”

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij projektvendimi ngarkohen, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Njësitë e Vetqeverisjes Vendore, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Agjencia Kombëtare e Pyjeve dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Dokumenti është hartuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe projektvendimi është konsultuar me të gjitha strukturat e varësisë të ministrisë.

Ky projektvendim do t'i dërgohet për mendim Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Brendëshme, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, si dhe Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Miratimi i projektvendimit nuk ka kosto mbi buxhetin e Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe për rrjedhojë as në buxhetin e shtetit.

Nga ana financiare ky dokument ofron lehtësi, pasi kërkuesit do të mund ta kërkojnë ofrimin e shërbimit nëpërmjet platformës *e-albania*.

PROPOZUESI

MINISTRI

MIRELA KUMBARO-FURXHI

